



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2793_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2700_05_25** i datës 16.05.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 29.05.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Xh. N., nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2700_05_25 i datës 16.05.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 16.05.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2700_05_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit Xh. N., lidhur me kontestimin e faturimit si konsumator vet – prodhues.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori Xh. N., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori pohon që në rastin e tij të ketë shkelje kushtetuese, sepse i njëjti e injekton energjinë në rrjet, kur çmimi i energjisë është më i lartë, ndërkaq e blen gjatë natës kur çmimi është më i ulët dhe çmimi i blerjes nga rrjeti është deri në 13.29 cent/kWh ndërsa çmimi i shitjes /injektimit është vetëm 3.19 cent/kWh me një diferencë diskriminuese deri në 10 cent për kWh, e që dëmton rëndë interesin ekonomik të prosumerëve.
- Më tej, pohon të ketë shkelje të së drejtës për qasje të barabartë në tregun e energjisë, sepse, praktika aktuale e zeron bilancin e energjisë së prodhuar pas 6 muajve, nuk e lejon bartjen në vitin pasues dhe nuk e kompenson me vlerë reale në euro.
- Po ashtu, konsumatori pohon të ketë edhe mospërputhje me Direktivat Evropian për Energjinë e pastër;



- I propozon Bordit që, të shfuqizohet Vendimi i DMK-së i dt. 16.05.2025, njohjen e energjisë së injektuar prej 3019.44 kWh si pasuri reale, që nuk duhet zërohet pa kompensim, kompensim financiar në euro për tepricën neto prej 1188.07 kWh me çmim të njëjtë ose proporcional me çmimin e energjisë së blerë nga rrjeti, zbatimin e barazisë tarifore, netimi i energjisë të bëhet një herë në vit dhe të ndryshohet Rregullorja nr. 03/2023 në pjesën ku i lejohet KESCO-s ta zerojë bilancin pozitiv pas 6 muajve, pasi ky mekanizëm shkel parimet e të drejtës pronësore, investimeve dhe barazisë ekonomike.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 29.05.2025; Vendimin e DMK të datës 16.05.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 23.12.2024; Përgjigjën e KESCO-s të datës 29.01.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 14.02.2025; Faturat e muajve 08/2024 – 01/2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Me datë 14.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke i kontestuar faturat e periudhës 11/12/2024 përfshirë edhe faturimin e periudhës 01/2025 duke potencuar faktin se është prosumator dhe se barazimi i energjisë se futur ne rrjet dhe ai i marr nga rrjeti nuk është duke u bere saktë. Po ashtu konsumatori ka parashtruar edhe ankesë ndaj mënyrës se barazimit, afatit si dhe çmimit te energjisë se blere nga KESCO. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që faturat e kontestuar te rishqyrtohen duke theksuar se çmimi i energjisë se injektuar duhet te jetbarabartë me çmimin e blerjes së energjisë, te lejohet barazimi i prodhimit dhe konsumit te energjisë (netimin) vetëm një here ne vit (me 31 dhjetor), te sigurojë qe konsumatorët qe prodhojnë energji te pastër te kenë një trajtim te drejt tariforë si dhe te rishikojë ligjshmërinë e vendimit refuzues te KESCO-së dhe te kërkojë shpjegime mbi metodologjinë e përdorur per tarifim.

Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit konstaton se konsumatori ka lexime te rregullta mujore, vetëm ne disa periudha lexuesit e KEDS-it kane evidentuar “Sugjerim per zhvendosje, mungon bllomba si dhe nuk ka qasje ne lexim”, por qe kjo nuk ka ndikim ne faturimet kontestuese te konsumatorit, kurse nga periudha 07/2024 kur edhe është vendosur per matje njehsori elektrik nr. 66009140 dy drejtimesh leximet dhe faturimet e konsumatorit janë bere nga distanca përmes AMR.

Me date 03.05.2024 ZRRE bazuar ne kërkesën e konsumatorit per ndërrimin e statusit përkatësisht marrjen e statusit si prosumator (konsumator vetë-prodhues) ka lëshuar vendimin me Nr. V_1970_2024 me te cilin ka aprovuar kërkesën e konsumatorit per ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese per vetë konsum nga panelet solare me kapacitet te instaluar prej 7 kW. Pika katër e Vendimit te lëshuar nga ZRRE, per ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese per vetë-Konsum, përcakton



se aplikuesi Xheli Neziri do të lidhë marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilin ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimi teknik nga KEDS Sh.A në pajtim me nenin 7 paragrafin 5 dhe 6 të Rregullës Nr.03/2023 për Vet - Konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme.

Me datë 05.07.2024 punëtorët e autorizuar të KEDS-it bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4345 datë 12.04.2024 kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.9042146 me gjendje TL=67714.6 kWh dhe TU=55078.4 kWh si dhe kanë vendosur njehsorin dy drejtimesh nr. 66009140 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Me datë 09.07.2024, bazuar edhe në vendimin e ZRRE-së me Nr. V_1970_2024 dhe Rregullës Nr.03/2023, Aplikuesi ka lidhur Marrëveshje për Vetë-Konsumatorët e energjisë së Ripërtëritshme sipas skemës mbështetëse të faturimit neto me furnizuesin KESCO dhe se kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë 12 vjeçare duke filluar nga 09.07.2024 (Data e operimit komercial) ose deri në datën e shkëputjes. Në këtë marrëveshje po ashtu janë të parapara kushtet e pranimi të Distributimit të energjisë elektrike përfshirë edhe energjinë elektrike të dorëzuar dhe faturuar. Pra, në nenin 4 të kësaj marrëveshje është e përcaktuar saktë edhe mënyra dhe forma e faturimit me rastin e marrjes si dhe dhënies së energjisë në rrjetin elektrik, si për bilanci pozitiv ashtu edhe ato negative të energjisë elektrike. Bordi e ka analizuar Marrëveshjen për Vetë-Konsumatorët e energjisë së Ripërtëritshme sipas skemës mbështetëse të faturimit neto të lidhur në mes Aplikuesit dhe furnizuesit KESCO dhe konstaton se kjo marrëveshje është në përputhje të plotë me nenin 7 paragrafin 5 dhe 6 të Rregullës Nr.03/2023.

Sa i përket pretendimeve të konsumatorit i cili ka kundërshtuar mënyrën e barazimit, afatit si dhe çmimit të energjisë së blerë nga KESCO, Bordi thekson se kjo nuk qëndron pasi që e njëjta është e rregulluar me nenin 9 të Rregullës Nr.03/2023 - Llogaritja e Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto, e ku thuhet se:

1. Teprica e energjisë elektrike që nuk konsumohet nga Prosumatori në kuadër të Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto do të merret nga Furnizuesi, me të cilin Prosumatori ka një kontratë furnizimi për Prosumatorët brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto.
2. Sasia e energjisë elektrike të tërhequr dhe sasia e energjisë elektrike të tepërt përcaktohen në bazë të leximeve të njehsorëve në pikën matëse.
3. Prosumatorët kanë të drejtën e kompensimit për energjinë elektrike të tepërt përmes një kreditimi monetar në Euro. Kompensimi do të llogaritet në bazë të netos së vlerës monetare të energjisë elektrike, vetëm për komponentët e energjisë, të tërhequra nga rrjeti dhe vlerës monetare të tepicës së energjisë elektrike të futur në rrjet brenda një Periudhe Faturimi e cila do të merret parasysh kur të përgatiten faturat e energjisë elektrike nga Furnizuesi.
4. Çmimi për përcaktimin e vlerës monetare të energjisë elektrike të tepërt të futur në rrjet do të jetë çmimi i komponentit të energjisë dhe do të llogaritet për çdo periudhë tarifore sipas formulës së mëposhtme:

$$C_{tepert}^{PT} = C \times C_{furnizuar}^{PT}$$

ku:



ζ_{tepert}^{PT}

- Çmimi për energjinë elektrike të tepërt gjatë periudhës tarifore PT dhe brenda periudhës së faturimit;

$\zeta_{furnizuar}^{PT}$

- Çmimi i furnizimit me energji elektrike i llogaritur nga ZRRE gjatë periudhës tarifore PT (vetëm komponenti energjetik i çmimit të furnizimit me energji elektrike, pa tarifë dhendonjë pagesë dhe taksë tjetër) brenda periudhës së faturimit.

C

- Koeficienti i çmimit. Vlera e koeficientit është 0,85 për konsumatorëte kyçur në nivelin e tensionit 0.4kV, ndërsa 0.80 është për konsumatorët e kyçur në rrjetin e tensionit të mesëm dhe në transmetim. Këta koeficiente aplikohen për konsumatorët e rregulluar me qëllim të menaxhimit të kostove administrative dhe kostove të jo-balanceve nga FSHU. Vlera e koeficientit C do të rishikohet periodikisht nga ZRRE-ja (të paktën çdo dy vjet). Çdo ndryshim i mundshëm i koeficientit do të bëhet me vendim të ZRRE-së, brenda përcaktimeve të kësaj Rregulle.
- Tek konsumatorët jashtë Skemës Mbështetëse vlera e koeficientit C mund të negociohet ndërmjet konsumatorit dhe furnizuesve, por vlera e koeficientit C nuk mund të jetë më e ulët se 0,70.

5. Nëse vlera monetare e energjisë elektrike të tepërt është më e madhe se vlera monetare e komponentit të energjisë së tërhequr nga rrjeti për të njëjtën periudhë Faturimi, kreditimi monetar në Euro i llogaritur në bazë të Netos së dy (2) vlerave të mëparshme të energjisë elektrike, do të transferohet në periudhën tjetër të Faturimit. Kreditimi monetar duhet të shfrytëzohet nga Prosumatori brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh, përveç periudhës së parë të shfrytëzimit kur mund të jetë më e shkurtër se gjashtë (6) muaj, dhe në fund të kësaj periudhe vlera monetare rivendoset në zero (0).

6. Kreditimi monetar, sipas paragrafit 5 të këtij Neni, do të rivendoset në datën 1 janar dhe 1 korrik të çdo viti.

Po ashtu në marrëveshjen e nënshkruar për Vetë-Konsumatorët e energjisë se Ripërtëritshme sipas skemës mbështetëse të faturimit neto me furnizuesin KESCO, në nenin 4 paragrafin 11 thuhet se: *“Furnizuesi i rikthen Bilancet Pozitive në zero më 1 janar dhe 1 korrik të çdo viti, shoqëruar me faturën e fundit të periudhës së faturimit, nëse ekzistojnë Balance Pozitive në atë kohë”*, pra barazimi i balanceve behet dy herë gjatë vitit.

Bordi i ka shqyrtuar bilancet e energjisë se konsumatorit, prodhimin si dhe konsumin nga rrjeti duke analizuar të gjitha faturat nga periudha 07/2024 dhe konstaton se bazuar në matjet dhe leximet e bëra janë bërë barazime të sakta, ku nga energjia e konsumuar si dhe ajo e futur në rrjet janë bërë barazimet e balanceve të energjisë si dhe në vlera financiare në përputhje me, Rregullën për Vet - Konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme nr. 03/2023.

Bordi bazuar në shqyrtimin e faturave kontestuese, rrjedhës se energjisë elektrike, listave të leximit konstaton se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhës kontestuese ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me



Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, “*të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja*”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i shqyrtoi edhe provat e tjera materiale të prezantuara nga konsumatori, por që, si të tilla nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast, andaj, nuk do të lëshohet në shqyrtim dhe elaborim të mëtejme të tyre.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit, Rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **Xh. N.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së